

Mësimet Bashkëkohore që Lidhen me Titullin e Lirisë

“Në kujtim të Perëndisë tonë”

Plaku Nil L. Andersen, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dha mësim:



“Ka shumë njerëz në botë që dinë fare pak për Jezun Krishtin, dhe, në disa pjesë të botës ku emri i Tij është shpallur ndër shekuj, besimi në Jezun Krisht po pakësohet. . . .

Kur bota flet më pak për Jezun Krishtin, le të flasim ne më shumë për Të. Kur bindjet tona të vërteta si dishepuj të Tij zbulohen, shumë përreth nesh do të jenë të përgatitur të dëgjojnë.” (Nil L. Andersen, “Ne Flasim për Krishtin”, *Liahona*, nëntor 2020, f. 88, 90)

“Në kujtim të . . . fesë sonë”

Presidenti Dallin H. Oaks, i Presidencës së Parë, dha mësim:



“Nëse ndalojmë së vlerësuar kishat tona për çfarëdo arsyeje, ne kërcënojmë jetën tonë vetjake shpirtërore dhe numri i konsiderueshëm i atyre që shpëtohen nga Perëndia, i pakëson bekimet e Tij për kombet tona.

Frekuentimi dhe aktivizimi në një kishë na ndihmojnë të bëhemi njerëz më të mirë dhe të jemi ndikim më i mirë në jetën e të tjerëve. Në kishë na mësohet se si t'i zbatojmë parimet fetare. Ne mësojmë nga njëri-tjetri. . . .

. . . Lutem që të gjithë ne të jemi të palëkundur në këto përvoja të Kishës ndërsa kërkojmë jetën e përjetshme, më të madhen nga të gjitha dhuratat e Perëndisë.” (Dallin H. Oaks, “Nevoja për një Kishë”, *Liahona*, nëntor 2021, f. 24, 26)

“Në kujtim të . . . lirisë sonë”

Plaku Ronald A. Rasband, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dha mësim:



“Çfarë është liria fetare?”

Është liria e adhurimit në të gjitha format e saj: liria për t'u mbledhur, liria e fjalës, liria për të vepruar sipas bindjeve vetjake dhe liria që të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë. Liria fetare e lejon secilin prej nesh të vendosë vetë se çfarë besojmë, si jetojmë e si veprojmë sipas besimit tonë dhe se çfarë pret Perëndia prej nesh. . . .

Ju ftoj ta mbronni kauzën e lirisë fetare. Ajo është shprehje e parimit të lirisë së zgjedhjes të dhënë nga Perëndia.

Liria fetare i sjell në ekuilibër filozofitë konkurruese. E mira e fesë, shtrirja e saj dhe veprat e përditshme të dashurisë që feja frymëzon, shumëfishohen vetëm kur e mbrojmë lirinë për t'u shprehur dhe për të vepruar sipas bindjeve bazë.” (Ronald A. Rasband, “Për të Shëruar Botën”, *Liahona*, maj 2022, f. 91, 93)

“Në kujtim të . . . paqes sonë”

Plaku Xhefri R. Holland, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dha mësim:



“Shëruesi i çdo plage, Ai i cili e ndreq çdo gabim, kërkon prej nesh që të punojmë me Të në detyrën e vështirë të paqebërësit në një botë që nuk do ta gjejë atë në ndonjë mënyrë tjetër. . . .

. . . Ju kërkoj të jeni paqebërës – ta doni paqen, ta kërkonit paqen, ta krijoni paqen dhe ta çmoni paqen. E bëj atë thirrje në emër të Princit të Paqes.” (Xhefri R. Holland, “Shërbesa e Pajtimit”, *Liahona*, nëntor 2018, f. 79)

“Në kujtim të . . . [familjeve] tona”

Motra Boni L. Oskarson, ish-Presidente e Përgjithshme e Të Rejave, dha mësim:



“Çdonjëra, pavarësisht nga rrethana e saj martesore apo numri i fëmijëve, mund të jetë mbrojtëse e planit të Zotit të përshkruar në proklamatën mbi familjen. Nëse është plani i Zotit, ai duhet të jetë edhe plani ynë! . . .

. . . Le të ndihmojmë në ndërtimin e mbretërisë së Perëndisë duke u ngritur në këmbë me guxim dhe duke u bërë mbrojtëse të martesës, prindërimit dhe të shtëpisë. Zoti do që ne të jemi luftëtare trimëresha, të patundura dhe të palëvizshme, të cilat do ta mbrojnë planin e Tij dhe do t’ua japin mësim të vërtetat e Tij brezave të ardhshëm.” (Boni L. Oskarson, “Mbrojtëse të Proklamatës së Familjes”, *Liahona*, maj 2015, f. 15, 17)